



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 01 tetor 2012
Nr. ref.: AGJ 309/ 12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr.

KI 132/10, KI 28/11, KI 82/11, KI 85/11, KI 89/11, KI 100/11, KI 104/11, KI 109/11, KI 118/11, KI 123/11, KI 142/11, KI 143/11, KI 144/11, KI 154/11, KI 01/12, KI 02/12, KI 14/12

Parashtrues të kërkesës

Istref Halili dhe 16 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së 17 aktgjykimeve individuale të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

1. Ky aktgjykim ka të bëjë me kërkesat e paraqitura nga parashtruesit e shënuar më poshtë, të parashtruara në Gjykatën Kushtetuese nga shtatëmbëdhjetë (17) ish-punëtorë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ndërmjet dhjetorit 2010 dhe shkurtit 2012.
2. Rastet në fjalë janë të ngjashme me rastin KI Nr. 40/09, “Imer Ibrahimimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës”, me rastin “Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës” dhe me rastin “Isuf Mërlaku dhe 25 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 17 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës” dhe “Ilaz Halili dhe 19 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës. Gjykata Kushtetuese vërejt se në të gjitha këto aktgjykime ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Mbrotjtja e Pronës) në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për disa prej parashtruesve. Si rrjedhojë, është marr vendim për t’i shpallur të pavlefshme aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme në disa prej atyre rasteve dhe për t’ia kthyer këto raste Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese (shih aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të 23 qershorit 2010, 18 tetorit 2010, 10 marsit 2011 dhe 27 dhjetor 2011).

Parashtrues të kërkesës në rastin në fjalë janë:

3. Në këtë aktgjykim, për referim më të lehtë, parashtruesit mund të referohen kolektivisht si “Istref Halili dhe shtatëmbëdhjetë (17) ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK)”.
 - 1) Istref Halili
 - 2) Ahmet Bytyqi
 - 3) Nazmi Kelmendi
 - 4) Selim Krasniqi
 - 5) Ramadan Duraku
 - 6) Shefqet Shala
 - 7) Habib Muja
 - 8) Brahim Shabani
 - 9) Nexhat Latifi
 - 10) Enver Hashani
 - 11) Sefe Isufi
 - 12) Syla Shefiku
 - 13) Lute Luta
 - 14) Ahmet Krasniqi
 - 15) Brahim Imeri
 - 16) Tafil Miftari

Parashtruesit i kontestojnë aktgjykimet në vijim të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra në rastet e: të datës

- | | |
|--------------|--|
| 1) KI 132/10 | Istref Halili, Rev. 60/2009 i 11 shkurtit 2009 |
| 2) KI 28/11 | Ahmet Bytyqi, Rev. 198/2009 i 15 korrikut 2009 |
| 3) KI 82/11 | Nazmi Kelmendi, Rev. 529/2008 i 11 shkurtit 2009 |
| 4) KI 85/11 | Selim Krasniqi, Rev. 103/2008 i 27 janarit 2009 |

- | | |
|---------------|--|
| 5) KI 89/11 | Ramadan Duraku, Rev. 138/2008 i 27 janarit 2009 |
| 6) KI 100/11 | Shefqet Shala, Rev. 339/2008 i 10 shkurtit 2009 |
| 7) KI 104/11 | Habib Muja, Rev. 511/2008 i 11 shkurtit 2009 |
| 8) KI 109/11 | Brahim Shabani, Rev. 261/2008 i 10 shkurtit 2009 |
| 9) KI 118/11 | Nexhat Latifi, Rev. 88/2009 i 23 shkurtit 2009 |
| 10) KI 123/11 | Enver Hashani, Rev. 123/2009 i 2 qershorit 2009 |
| 11) KI 142/11 | Sefe Isufi, Rev. 456/2008 i 10 marsit 2009 |
| 12) KI 143/11 | Syla Shefiku, Rev. 509/2008 i 23 shkurtit 2009 |
| 13) KI 144/11 | Lute Luta, Rev. 496/2008 i 11 shkurtit 2009 |
| 14) KI 154/11 | Ahmet Krasniqi, Rev. 85/2009 i 23 shkurtit 2009 |
| 15) KI 01/12 | Brahim Imeri, Rev. 510/2008 i 10 marsit 2009 |
| 16) KI 02/12 | Tafil Miftari, Rev. 451/2008 i 11 shkurtit 2009 |
| 17) KI 14/12 | Nuhi Gerguri, Rev. 418/2009 i 10 marsit 2010 |

Objekti i çështjes

- Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve individuale të nxjerra nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës në shtatëmbëdhjetë (17) rastet individuale të parashtruesve kundër KEK-ut, siç është cekur më lart.

Baza juridike

- Kërkesa bazohet në nenin 113 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe nenin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Përmbledhje e fakteve siç pretendohen nga palët

- Faktet e këtyre kërkesave janë të ngjashme me ato në rastin “Imer Ibrahimimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës”, me rastin “Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës” dhe me rastin “Isuf Mërlaku dhe 25 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës”. Shih aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: rasti “Ibrahimimi dhe të tjerët”, i 23 qershorit 2010, rasti “Prokshi dhe të tjerët”, i 18 tetorit 2010, rasti “Mërlaku dhe të tjerët” i 10 marsit 2011 dhe “rasti Halili dhe të tjerët”, i 27 dhjetorit 2011).
- Gjatë vitit 2001 dhe 2002, secili parashtrues në këtë kërkesë, si dhe parashtruesit në aktgjykimin e lartcekur, të 23 qershorit 2010, 18 tetorit 2010, 10 marsit 2011 dhe 27 dhjetorit 2011 nënshkruan marrëveshje për kompensim të përkohshëm të pagesës për shkëputje të kontratës së punës me punëdhënësin e tyre, KEK-un. Këto marrëveshje ishin, në thelb, të njëjta.
- Neni 1 i kësaj Marrëveshjeje përcaktoi se, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. 26/83, 26/86 dhe 11/88) dhe konstatimit të Komisionit Invalidor të KEK-ut, përfituesi (d.m.th. secili parashtrues) ka të drejtë për kompensim të përkohshëm për ndërprerje të marrëdhënies së punës, deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor.
- Neni 2 i kësaj Marrëveshjeje përcaktoi se shuma mujore që duhet t’i paguhet secilit parashtrues ishte 206 marka gjermane.

10. Neni 3 përcaktoi që “pagesa do të përfundojë në ditën e funksionimit të Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Prej asaj dite e tutje, shfrytëzuesi mund t'i realizojë të drejtat e veta në Fondin e Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor (Fondi Pensional Invalidor i Kosovës), dhe KEK-ut do t'i hiqen obligimet ndaj shfrytëzuesit sipas kësaj Marrëveshjeje”.
11. Më 1 nëntor 2002, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut miratoi një vendim për themelimin e Fondit Pensional, në përputhje me kriteret e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/30 për Pensionet në Kosovë. Neni 3 i këtij vendimi thotë: “Fondi Pensional do të vazhdojë të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar kohore, në pajtim me kriteret dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjet për pensione, të miratuara nga Bordi i Fondit Pensional dhe KEK-u, në përputhje me këtë vendim, apo derisa kushtet ligjore për ekzistimin dhe funksionimin e Fondit të jenë në përputhje me rregulloret për pension ose rregullat për pension të miratuara nga ABPK-ja.”
12. Më 25 korrik 2006, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut e anuloi vendimin në fjalë për themelimin e Fondit Pensional Suplementar dhe ndërpreu financimin dhe punën e Fondit Pensional Suplementar, që nga 31 korriku 2006. Sipas vendimit të 25 korrikut 2006, të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e Fondit. Për më tepër, obligimi i përgjithshëm ndaj përfituesve ishte 2.395.487 euro, depozitat bankare ishin 3.677.383 euro, dhe suficiti nga përgjegjësia ishte 1.281.896 euro. Vendimi thotë se punëtorët e KEK-ut të cilët Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i pranon si persona me aftësi të kufizuar për punë do t'i gëzojnë të drejtat e parapara nga Ministria. Më 14 nëntor 2006, KEK-u e informoi Autoritetin Qendror Bankar se “vendimi për revokimin e Fondit Pensional të KEK-ut bazohet në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KEK-ut dhe në vendimin e Bordit Menaxhues për Pensione ... për shkak të rrezikut financiar që kjo skemë paraqet për KEK-un në të ardhmen.”
13. Sipas parashtruesve, KEK-u ndërpreu pagesën e paraparë me marrëveshjet e verës së vitit 2006 pa asnjë njoftim. Parashtruesit pohojnë që një veprim i tillë është në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkruara.

Parashtruesit gjithashtu theksojnë se dihet se Fondi Pensional dhe Invalidor në Kosovë nuk është themeluar ende.

Në anën tjetër, në rastin fillestar, KEK-u kontestoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke argumentuar se dihet botërisht se Fondi Pensional në Kosovë funksionon që nga 1 janari 2004.
14. Sipas KEK-ut, parashtruesit ishin mbuluar automatikisht nga skema kombëtare invalidore në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore në Kosovë (Ligji Nr. 2003/23).
15. KEK-u më tutje pohoi që më 31 gusht 2006 lëshoi një njoftim sipas të cilit të gjithë përfituesit e Fondit Suplementar të KEK-ut ishin njoftuar se Fondi ishte mbyllur. I njëjti njoftim konfirmonte se të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e FPS-së, që do të thotë 60 muaj pagesë ose derisa përfituesit ta arrijnë moshën 65-vjeçare, në përputhje me Vendimin e Bordit Menaxhues të Fondit Pensional të 29 gushtit 2006.
16. KEK-u më tutje tha që parashtruesit nuk i kishin kontestuar udhëzimet për pension invalidor dhe nënshkrimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në përputhje me konkluzionet e Komisionit Invalidor.

17. Parashtruesit ngritën padi kundër KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilën kërkonin që Gjykata ta urdhëronte KEK-un t'ua paguante pagesat e papaguara dhe të vazhdonte t'ua paguante nga 105 euro (që është e barabartë me 206 marka gjermane) deri në përmbushjen e kushteve për ndërprerjen e pagesës.
18. Gjykata Komunale në Prishtinë i miratoi paditë e parashtruesve dhe urdhëroi kompensim monetar. Gjykata Komunale në Prishtinë konstatoi (*p.sh. Aktgjykimi C. Nr. 1863/2007, i 23 prillit 2008, në rastin e parashtruesit të parë Istref Halili*) se kushtet e parapara në nenin 3 të Marrëveshjes nuk ishin përmbushur. Neni 3 i Marrëveshjes parashikon kompensimin e pagës deri në realizimin e të drejtës së parashtruesve, "që do të thotë të drejtën për skemë të pensioneve."
19. KEK-u paraqiti ankesë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale pranë Gjykatës së Qarkut, duke thënë, ndër të tjera, se aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk ishte i drejtë sepse marrëveshjet ishin nënshkruar me parashtruesit për shkak të invaliditetit të tyre dhe se nuk mund të kërkojnë vazhdimin e marrëdhënies së tyre të punës për shkak të invaliditetit të tyre.
20. KEK-u ritheksoi se Gjykata ishte e detyruar të vendoste duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore, sipas të cilës parashtruesit kishin të drejtë për pension invalidor.
21. Gjykata e Qarkut në Prishtinë i hodhi poshtë ankesat e KEK-ut dhe i konsideroi parashtruesit të tyre të pabazuar.
22. KEK-u parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes së supozuar thelbësore të Ligjit për procedurën kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Aty përsëritej që parashtruesit kishin të drejtë për pension sipas Ligjit 2003/40 dhe që për shkak të arsyeve humanitare KEK-u kishte vazhduar t'i paguante kompensimet ujore edhe pas hyrjes së Ligjit në fuqi. KEK-u pohonte që nuk ishte në pyetje mosha e parashtruesit, por invaliditeti i tij.
23. Gjykata Supreme i miratoi revizionet e KEK-ut, i anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale në Prishtinë, dhe i refuzoi si të pabaza paditë e parashtruesve.
24. Gjykata Supreme theksoi që mënyra e ndërprerjes së punësimit konsiderohej e ligjshme sipas nenit 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.
25. Në aktgjykimin e vet në rastin e parashtruesit të parë, Istref Halili, Rev. Nr. 60/2009, të 11 shkurtit 2009, Gjykata Supreme theksoi: "*Duke marrë parasysh faktin e pakontestueshëm që pala e paditur e ka përmbushur obligimin ndaj paditësit, që është pagesa e kompensimit të pagave sipas periudhës së specifikuar, që është deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, në fuqi prej 1 janarit 2004, Gjykata vërejtë që pala e paditur e ka kryer obligimin sipas marrëveshjes. Kështu, pohimet e paditësit që pala e paditur ka për obligim t'ia paguajë atij kompensimin e përkohshëm të pagave pas themelimit të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë konsiderohen nga kjo Gjykatë si të pabazuar për shkak se palët kontraktuese, deri në shfaqjen e kushtit shfuqizues – themelimin e fondit të lartpërmendur, i kanë kryer obligimet e tyre kontraktuese...*"
26. Më 15 maj 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës lëshoi këtë njoftim: "*Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, në arsyetimin e vet të p.sh. Aktgjykimit Rev. Nr. 338/2008, që në Republikën e Kosovës ekziston Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor që është funksional që nga 1 janari 2004 nuk është i saktë dhe është i*

pabazuar. Në dhënien e kësaj deklarate, ne kemi parasysh faktin që Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/40 shpall Ligjin Nr. 2003/213 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, i cili i rregullon rastet e personave me paaftësi të përhershme, të cilët mund ta gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Prandaj, më lejoni të theksoj që dispozitat e këtij Ligji nuk parashikojnë themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vendit. Themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës.” Në të njëjtin njoftim shpjegohej që në kohën e shkrimit të atij njoftimi, pensioni ndër të tjera ekzistonte, “pensionin invalidor në shumë prej 45 eurove, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (përfitues të tyre janë të gjithë personat me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme)”, si dhe “pensionet e kontributdhënësve prej 82 eurove, që rregullohen me vendim të Qeverisë (përfitues të të cilit janë të gjithë pensionistët që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh, si dhe të cilët kanë së paku 15 vjet përvojë pune).”

Ankesat

27. Parashtruesit ankohen që të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u në mënyrë të njëanshme i ka anuluar marrëveshjet e tyre, përkundër faktit se kushti i përcaktuar me nenin 3, themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, nuk ishte përmbushur. Parashtruesit theksuan më tutje se nuk kanë pasur mundësi ta kundërshtojnë një shkelje të tillë në gjykatat e rregullta. Ndërsa parashtruesit nuk ankohen shprehimisht për shkeljen e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nga parashtruesit e tyre duket se objekt i ankesave janë të drejtat e tyre pronësore (siç garantohet me nenin 1, Protokollin 1 të KEDNJ-së), si dhe e drejta e tyre për gjykim të drejtë (siç garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së).

Përmbledhje e procedurave në Gjykatë

28. Ndërmjet shtatorit 2010 dhe shkurtit 2012, parashtruesit individualisht i kanë dorëzuar kërkesat në Gjykatën Kushtetuese. Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe e caktoi Kolegjin shqyrtues të Gjykatës të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Ivan Čukalović.

29. Më 3 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Altay Suroy, Enver Hasani dhe Ivan Čukalović, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për pranueshmëri të kërkesës.

30. Të njëjtën ditë, Gjykata u këshillua dhe votoi për këtë rast.

Pranueshmëria

31. Siç është vendosur në rastet “Ibrahimi dhe të tjerët”, “Prokshi dhe të tjerët” “Mërlaku dhe të tjerët” dhe “Halili dhe të tjerët”, të përmendura më lart, për të gjykuar për kërkesat e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë.

32. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”;

dhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili thotë:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë parashtruar kërkesat e tyre brenda afatit prej katër muajve, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili thotë:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”

34. Gjykata rikujton që në rastin në fjalë, ngjashëm si në rastet “Ibrahimi dhe të tjerët”, “Prokshi dhe të tjerët”, “Mërlaku dhe të tjerët” dhe “Halili dhe të tjerët”, parashtruesit ende vuajnë nga ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve të tyre të nënshkruara nga KEK-u. Ata kanë ngritur të njëjtin argument ashtu si parashtruesit e mëhershëm, në kuptimin se dihet mirëfilli që Fondi Pensional dhe Invalidor nuk është themeluar deri më sot. Pra, ekziston një situatë e vazhdueshme. Pasi rrethanat për të cilat parashtruesit ankohen kanë vazhduar, afati prej katër muajve, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit, nuk është i zbatueshëm për këto raste.

35. Gjykata Kushtetuese është e njoftuar që disa prej parashtruesve ishin më të vjetër se 65 vjeç në kohën e parashtrimin të kërkesës së tyre pranë kësaj Gjykate.

36. Këta parashtrues janë: Istref Halili (1943), Selim Krasniqi (1942), Ramadan Duraku (1945). Habib Muja (1945), Brahim Shabani (1942), Sefë Isufi (1943), Ahmet Krasniqi (1943) dhe Tafil Miftari (1943).

37. Gjykata Kushtetuese rikujton se, sipas njoftimit të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale më 15 maj 2009, personave që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh dhe që i kanë së paku 15 vjet përvojë pune u takon pensioni në shumë mujore prej 82 eurove. Thelbi i këtij njoftimi u konfirmua nga përfaqësuesi i Ministrisë në seancën publike që Gjykata Kushtetuese e mbajti më 30 prill 2010 në rastin “Ibrahimi dhe të tjerët”.

Rrjedhimisht, duket që parashtruesit e lartpërmendur kanë të drejtë për pension që nga momenti kur i kanë mbushur 65 vjet.

Megjithatë, ankesa e tyre lidhur me kompensimin e papaguar për periudhën para atij momenti, për shkak të situatës së vazhdueshme, mbetet në shqyrtim.

38. Prandaj, kërkesat e parashtruesve: Istref Halili, Selim Krasniqi, Ramadan Duraku. Habib Muja, Brahim Shabani, Sefë Isufi, Ahmet Krasniqi dhe Tafil Miftari janë pjesërisht të pranueshme.

39. Sa u përket parashtruesve të tjerë, Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë arsye për papranueshmëri të kërkesës.

40. Gjykata më tej konsideron se është e përshtatshme të bëhet bashkimi i kërkesave në përputhje me rregullin 36 të Rregullores së punës.

Meritat

41. Gjykata rikujton aktgjykimet e veta të 27 dhjetor 2012, 18 tetor, dhe 10 mars 2011 dhe 27 dhjetor 2012, të miratuara në rastet e mëhershme të KEK-ut, në të cilat konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Mbrojtja e Pronës) në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të njëjtit parashtrues. Si rrjedhojë, ishte marrë vendim për t'i shpallur të pavlefshme aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme në rastet e parashtruesve dhe për t'ia kthyer ato aktgjykime Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

i. Sa i përket mbrojtjes së pronës

42. Parashtruesit ankohen se të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u i ka anuluar marrëveshjet e tyre në mënyrë të njëanshme, edhe pse kushti i përcaktuar me nenin 3 (pra themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor) nuk ishte përmbushur. Në thelb, parashtruesit ankohen se ka pasur shkelje të të drejtave të tyre pronësore.
43. Që në fillim, duhet rikujtuar këto dispozita ligjore:

Neni 53 i Kushtetutës

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës thotë me sa vijon:

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë shpronësimin e pronës nëse ky shpronësim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve shpronësohet.

Neni 1 i Protokollit nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton:

“Secili person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë posedimet e tij në mënyrë të qetë. Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij/saj përveç për interes publik si dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara me ligj, si dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat paravajtëse nuk do të pengojnë në asnjë mënyrë të drejtën e Shtetit që të zbatojë ligje që i konsideron të domosdoshme për kontrollimin e shfrytëzimit të pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, apo për të siguruar pagesën e tatimeve apo kontributeve e dënimeve tjera.”

44. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një parashtrues mund të pretendojë shkeljen e nenit 1 të Protokollit Nr. 1 vetëm deri në përmasën që

vendimet e kundërshtuara kanë të bëjnë me “posedimet” e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite.

45. Për më tepër, “posedimet” mund të jenë ose “posedime ekzistuese” ose asete, duke përfshirë pohimet, në kuptimin e të cilave parashtruesi mund të argumentojë që ai apo ajo ka së paku “pritje legjitime” të fitimit dhe gëzimit efektiv të një të drejte pronësore. Në kundërshtim me këtë, shpresa e njohjes së një të drejte pronësore e cila ka qenë e pamundur të ushtrohet në mënyrë efektive nuk mund të konsiderohet “posedim” sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, dhe as kërkesa me kusht, e cila mbaron si rezultat i mospërbushjes së kushtit” (shih aktgjykimet në rastet *“Ibrahimi dhe të tjerët”*, *“Prokshi dhe të tjerët”*, *“Mërlaku dhe të tjerët”* dhe *Halili dhe të tjerët*).
46. Çështja që duhet shqyrtuar në secilin rast është nëse rrethanat e rastit, të marra si tërësi, i japin parashtruesit pronësi ndaj një interesi thelbësor të garantuar me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. (Shih aktgjykimet në rastet *“Ibrahimi dhe të tjerët”*, *“Prokshi dhe të tjerët”* dhe *“Mërlaku dhe të tjerët”*).
47. Gjykata Kushtetuese vëren që në kohën e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërmjet parashtruesve dhe KEK-ut, ky lloj i marrëveshjeve është rregulluar me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore (Ligji për Obligimet), të shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së 29/1978 dhe të ndryshuar në 39/1985, 45/1989, 57/1989.

Neni 74(3) i Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore thotë me sa vijon:

“Pas lidhjes sipas kushtit shfuqizues, kontrata pushon të jetë e vlefshme pasi ai kusht është i vlefshëm.”

48. Prandaj, thelbi i çështjes është nëse është përmbushur kushti shfuqizues sipas të cilit marrëveshjet ishin nënshkruar. Përgjigja në këtë pyetje do t'i mundësojë Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse rrethanat e kësaj kërkesë, të shqyrtuara si tërësi, u japin parashtruesve të drejtën ndaj interesit thelbësor të mbrojtur me nenin 1, Protokollin Nr. 1 të KEDNJ-së.
49. Gjykata Kushtetuese vëren se nga dokumentet është e qartë, dhe e pakontestueshme ndërmjet palëve, se “kushti shfuqizues”, sipas të cilit janë nënshkruar marrëveshjet, është themelimi dhe funksionimi i Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor.
50. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren që sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor do të duhej të parashikohej me Ligjin për Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Ky ka qenë në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës.
51. Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesit, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve me KEK-un, kanë pasur pritje legjitime që do të gëzonin dëmshpërblim mujor në shumë prej 105 eurove, deri në themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor.
52. Një pritje e tillë legjitime garantohet me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës. Natyra e saj është konkrete, dhe jo vetëm shpresë e thjeshtë, dhe bazohet në një dispozitë ligjore apo akt ligjor, d.m.th. në marrëveshjen me KEK-un (aktgjykimet në rastet *“Ibrahimi dhe të tjerët”*, *“Prokshi dhe të tjerët”*, *“Mërlaku dhe të tjerët”* dhe *“Halili dhe të tjerët”*); po ashtu *mutatis mutandis* Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës së Çekisë (vendim), nr. 39794/98, paragrafi 73, ECHR 2002-VII).

53. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesit kanë “pritje legjitime” që kërkesa e tyre do të trajtohet në pajtim me ligjet në fuqi, në veçanti në pajtim me dispozitat e lartpërmendura të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore dhe të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, dhe si rrjedhojë do të miratohen (shih aktgjykimet në rastet “Ibrahimi dhe të tjerët”, “Prokshi dhe të tjerët” , “Mërlaku dhe të tjerët” dhe “Halili dhe të tjerët”).
54. Megjithatë, ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve, para përmbushjes së kushtit shfuqizues, i ka shkelur interesat materiale të parashtrueseve që ishin të njohura me ligj dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (shih aktgjykimet në rastet “Ibrahimi dhe të tjerët”, “Prokshi dhe të tjerët” , “Mërlaku dhe të tjerët” dhe “Halili dhe të tjerët”).
55. Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese konstaton se ka shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

ii. Sa i përket të së drejtës për gjykim të drejtë

56. Parashtruesit më tej ankohen se nuk kanë qenë në gjendje të zhdëmtohen për shkeljen e të drejtave të tyre pronësore në gjykatat e rregullta.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës thotë me sa vijon:

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet ... nga [një] gjykatë ... e cila do të vendosë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile ...”

57. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme. Në përgjithësi, “gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit” (neni 102 i Kushtetutës). Më saktësisht, roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
58. Në anën tjetër, “Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën” (neni 112.1 i Kushtetutës). Pra, Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë përkatëse dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të duhur saqë parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
59. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat që të japin arsyetime për aktgjykimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për përgjigje të hollësishme për secilin argument. Përmasa në të cilën zbatohet detyra e ofrimit të arsyetimeve mund të dallojë varësisht nga natyra e vendimit. Për më tepër, është e domosdoshme të merret parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmëria e parashtresave që një palë mund të dorëzojë në gjykata dhe dallimet që ekzistojnë në shtetet kontraktuese lidhur me dispozitat ligjore, rregullat zakonore,

mendimet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve. Prandaj, çështja nëse gjykatat kanë dështuar në përmbushjen e obligimit të parashtrimit të arsyeve, që burojnë nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në bazë të rrethanave të rastit (shih aktgjykimet në rastet “Ibrahimi dhe të tjerët”, “Prokshi dhe të tjerët”, “Mërlaku dhe të tjerët” dhe “Halili dhe të tjerët”);

60. Në rastin në fjalë, parashtruesit kanë kërkuar nga gjykatat e rregullta të vendosin për mosmarrëveshjen e tyre pronësore me KEK-un. Parashtruesit iu kanë referuar në veçanti dispozitës së nenit 3 të marrëveshjeve, duke theksuar se Ligji për Pensionet, që themelon Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, nuk është miratuar ende. Ky fakt është vërtetuar nga përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
61. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk ka bërë asnjë përpjekje për t'i analizuar paditë e parashtrueseve nga ky këndvështrim, përkundër referencës së qartë para çdo instance tjetër gjyqësore. Në vend të kësaj, pikëpamja e Gjykatës Supreme ka qenë se është fakt i pamohueshëm që pala kundërshtarë (KEK) i ka përmbushur obligimet e veta ndaj paditësit, që ka qenë pagesa e kompensimit të pagave sipas afatit të përcaktuar deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, në fuqi nga 1 janari 2004.
62. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vendosë se cila do të ishte mënyra më e mirë që gjykatat e rregullta t'i trajtojnë argumentet e parashtrueseve, d.m.th., përmbushjen e kushtit shfuqizues të nenit 3 të marrëveshjeve, përmbushje kjo që përcaktohet po ashtu me nenin 74 (3) të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore i marrë në lidhje me nenin 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vitit 1983.
63. Megjithatë sipas mendimit të kësaj Gjykate, Gjykata Supreme duke shpërfillur vlerësimin e kësaj pike në tërësi, edhe pse ishte specifike, përkatëse dhe e rëndësishme, ka dështuar në obligimin e saj sipas nenit 6 të paragrafit 1 të KEDNJ-së (shih rastet “Ibrahimi dhe të tjerët”, “Prokshi dhe të tjerët”, “Mërlaku dhe të tjerët” dhe “Halili dhe të tjerët”);
64. Nga sa u tha më lart, Gjykata Kushtetuese konkludon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

GJYKATA NJËZËRI VENDOSI ME SA VIJON:

I. T'I BASHKOHË KËRKESAT;

II. T'I SHPALLË SI:

a) Të pranueshme kërkesat në lidhje me parashtruesit në vijim:

KI 28/11 Ahmet Bytyqi
KI 82/11 Nazmi Kelmendi
KI 100/11 Shefqet Shala
KI 118/11 Nexhat Latifi
KI 123/11 Enver Hashani
KI 143/11 Sylja Shefiku
KI 144/11 Lute Luta
KI 01/12 Brahim Imeri

KI 14/12Nuhi Gerguri

b) Pjesërisht të pranueshme kërkesat në lidhje me parashtruesit në vijim:

KI 132/10	Istref Halili
KI 85/11	Selim Krasniqi
KI 89/11	Ramadan Duraku
KI 104/11	Habib Muja
KI 109/11	Brahim Shabani
KI 142/11	Sefë Isufi
KI 154/11	Ahmet Krasniqi
KI 02/12	Tafil Miftari

III. TË KONSTATOJË QË:

a) Ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e të gjithë parashtruesve;

b) Ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa u përket parashtruesve të njëjtë, që kanë pësuar shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.

IV. T'i shpallë të pavlefshme aktgjykimet e Gjykatës Supreme në këto raste:

KI 132/10 Istref Halili, Rev. 60/2009 i 11 shkurtit 2009
KI 28/11 Ahmet Bytyqi, Rev. 198/2009 i 15 korrikut 2009
KI 82/11 Nazmi Kelmendi, Rev. 529/2008 i 11 shkurtit 2009
KI 85/11 Selim Krasniqi, Rev. 103/2008 i 27 janarit 2009
KI 89/11 Ramadan Duraku, Rev. 138/2008 i 27 janarit 2009
KI 100/11 Shefqet Shala, Rev. 339/2008 i 10 shkurtit 2009
KI 104/11 Habib Muja, Rev. 511/2008 i 11 shkurtit 2009
KI 109/11 Brahim Shabani, Rev. 261/2008 i 10 shkurtit 2009
KI 118/11 Nexhat Latifi, Rev. 88/2009 i 23 shkurtit 2009
KI 123/11 Enver Hashani, Rev. 123/2009 i 2 qershorit 2009
KI 142/11 Sefe Isufi, Rev. 456/2008 i 10 marsit 2009
KI 143/11 Sylva Shefiku, Rev. 509/2008 i 23 shkurtit 2009
KI 144/11 Lute Luta, Rev. 496/2008 i 11 shkurtit 2009
KI 154/11 Ahmet Krasniqi, Rev. 85/2009 i 23 shkurtit 2009
KI 01/12 Brahim Imeri, Rev. 510/2008 i 10 marsit 2009
KI 02/12 Tafil Miftari, Rev. 451/2008 i 11 shkurtit 2009
KI 14/12 Nuhi Gerguri, Rev. 418/2009 i 10 marsit 2010

V. TËIA KTHEJË këto aktgjykime Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate.

VI. MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij Urdhri.

Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë pasi t'u dorëzohet palëve.

Prishtinë, më 26 shtator 2012

Gjyqtari raportues



Kadri Kryeziu,

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani